DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020- 712/3
Data. Datum. Date. 23.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Për:	**Novak Živić,** Kryetar i Komunës së Graçanicës **Milan Dimitrijević,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Graçanicës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	**Elbert Krasniqi,** Ministër i MAPL-së **Jeton Qela,** Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	**Erblin Hetemi,** Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 06.11.2026 Nr. 020-712
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	 **Xhevat Tafa,** Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit **Branko Mirić,** Zyrtar për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi preliminar Nr. 4435/26 (Nr. 55/2026/KG) për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – parcelës kadastrale P-1006-1, ZK Gushtericë e Poshtme, me një sipërfaqe prej 23.608 m²
I miratuar më datë: 30.10.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.11.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.**

Arsyetim

Kuvendi i komunës së Graçanicës, në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2026, ka miratuar Vendimin preliminar Nr. 4435/26 (Nr. 55/2026/KG) për fillimin e procedurës për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër – parcelës kadastrale P-1006-1, ZK Gushtericë e Poshtme, me një sipërfaqe prej 23.608 m².

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) konstaton se Vendimi i lartcekur nuk është në përputhje me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe me nenin 4, paragrafi 1, pika 2, dhe nenin 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Ligji Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës:

Neni 13, paragrafi 2: Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Rregullore (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës:

Neni 4, paragrafi 1, pika 2: Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;

Neni 6, paragrafi 2: Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Konkretisht, sipas të dhënave nga fleta poseduese, parcela kadastrale në fjalë tashmë është dhënë në shfrytëzim afatgjatë personit juridik SH.P.K. "Dino", për një periudhë prej 99 vjetësh, gjë që dëshmon ekzistimin e një të drejte të mëparshme të shfrytëzimit nga një palë e tretë. Në këtë drejtim, me nenin 4, paragrafi 1, pika 2 të Rregullores së lartcekur është përcaktuar se prona e paluajtshme që jepet në shfrytëzim duhet të jetë e liruar nga detyrimet ndaj palëve të treta. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh të drejtën ekzistuese të shfrytëzimit, prona në fjalë nuk e përmbush kriterin e përcaktuar, për çka Komuna ka qenë e obliguar që paraprakisht të qartësojë dhe rregullojë statusin e saj ekzistues juridiko-pronësor, para inicimit të një procedure të re për dhënien në shfrytëzim.

Për më tepër, është konstatuar mospërputhje ndërmjet Vendimit në fjalë dhe Vendimit Nr. 5867/25 të Kuvendit të komunës së Graçanicës për miratimin e listës së pronave të paluajtshme komunale të destinuara për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, të miratuar më datë 30.12.2025. Konkretisht, në listën e lartcekur, parcela në fjalë është planifikuar për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, për një periudhë kohore prej 15 deri në 99 vjet, ndërsa me Vendimin Nr. 4435/26 iniciohet procedura për dhënien e saj në shfrytëzim afatshkurtër, për një periudhë deri në 15 vjet.

Një mospërputhje e tillë nuk është në përputhje me nenin 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-092, si dhe me nenin 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, me të cilat përcaktohet se lista e pronave të paluajtshme të destinuara për dhënie në shfrytëzim duhet të përmbajë, ndër të tjera, edhe periudhën kohore për të cilën planifikohet të jepet prona në shfrytëzim. Rrjedhimisht, procedura për dhënien në shfrytëzim duhet të jetë në përputhje me të dhënat e përcaktuara dhe të miratuara paraprakisht në listën vjetore të pronave të paluajtshme komunale.

Në bazë të fakteve të paraqitura, MAPL vlerëson se Vendimi në fjalë nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, si në aspektin e statusit ekzistues juridiko-pronësor të parcelës në fjalë, ashtu edhe në aspektin e periudhës kohore për të cilën e njëjta është planifikuar të jepet në shfrytëzim.

Andaj, bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Graçanicës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 - 712/3
Data. Datum. Date. 23. 11. 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Za:	**Novak Živić,** Predsednik opštine Gračanica **Milan Dimitrijević,** Predsedavajući Skupštine opštine Gračanica	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	**Elbert Krasniqi,** Ministar MALS-a **Jeton Qela,** Generalni Sekretar MALS-a	
Od:	**Erblin Hetemi,** Direktor pravnog odeljenja MALS	Datum: 06.11.2026
Odgovorni službenici: 1. Službenik za potvrđivanje pravne ocene 2. Službenik za izradu pravnih procena	**Xhevat Tafa,** Rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i akata predsednika opštine **Branko Mirić,** Službenik za razmatranje zakonitosti opštinskih akata i akata gradonačelnika	Br. 020-712
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani predsedniče opštine,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članom 8. i 9. Zakona br. 08/L-284 o upravnom preispitivanju opštinskih akata i Uredbom (VRK) br. 03/2026 o postupku administrativnog razmatranja opštinskih akata, a na osnovu zakonskih nadležnosti Ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti sledeći akt opštine:

Preliminarna odluka br. 4435/26 (br. 55/2026/OG) o pokretanju procedure za davanje opštinske nepokretne imovine na kratkoročno korišćenje – katastarska parcela P-1006-1, KZ Donja Gušterica, površine 23608m²
Usvojena dana: 30.10.2026
Podneta na razmatranje u MALS-u dana: 04.11.2026

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon pregleda sadržaja opštinskog akta kao što je gore navedeno, ocenjuje da je opštinski akt **u suprotnosti sa važećim zakonodavstvom.**

Obrazloženje

Skupština opštine Gračanica, na sednici održanoj 30.10.2026. godine, usvojila je Preliminarnu odluku br. 4435/26 (br. 55/2026/OG) o pokretanju procedure za davanje opštinske nepokretne imovine na kratkoročno korišćenje – katastarska parcela P-1006-1, KZ Donja Gušterica, površine 23.608m².

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) konstatuje da navedena Odluka nije u skladu sa članom 13, stav 2, Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni opštinske nepokretne imovine, kao i članom 4, stav 1, tačka 2, i članom 6, stav 2, Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura za davanje na korišćenje i o razmeni opštinske nepokretne imovine.

Zakon br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i o razmeni opštinske nepokretne imovine:

Član 13, stav 2: Spisak nepokretnih imovina za davanje na korišćenje treba da sadrži sledeće podatke: katastarske podatke imovine, svrhu, namenu, datum objavljivanja obaveštenja i vremenski period za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine.

Uredba (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura za davanje na korišćenje i o razmeni opštinske nepokretne imovine:

Član 4, stav 1, tačka 2: da bude oslobođena obaveza prema trećim stranama;

Član 6, stav 2: Spisak nepokretnih imovina za davanje na korišćenje treba da sadrži sledeće podatke: katastarske podatke imovine, cilj, odredište, datum objavljivanja obaveštenja i vremenski period za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine.

Naime, prema podacima iz posedovnog lista, predmetna katastarska parcela već je data na dugoročno korišćenje pravnom licu D.O.O. „Dino", na period od 99 godina, što ukazuje na postojanje prethodno ustanovljenog prava korišćenja trećeg lica. S tim u vezi, članom 4, stav 1, tačkom 2 navedene Uredbe propisano je da nepokretna imovina koja se daje na korišćenje mora biti oslobođena obaveza prema trećim stranama. Shodno tome, imajući u vidu postojeće pravo korišćenja, predmetna nepokretnost ne ispunjava navedeni kriterijum, zbog čega je opština bila dužna da prethodno razjasni i reguliše njen postojeći imovinskopravni status, pre pokretanja nove procedure davanja na korišćenje.

Dodatno, utvrđena je nesaglasnost između predmetne odluke i odluke br. 5867/25 Skupštine opštine Gračanica o usvajanju spiska opštinske nepokretne imovine namenjene za davanje na korišćenje za 2026. godinu, usvojene dana 30.12.2025. godine. Naime, u navedenom spisku predmetna parcela planirana je za dugoročno davanje na korišćenje, u vremenskom periodu od 15 do 99 godina, dok se odlukom br. 4435/26 pokreće procedura za njeno kratkoročno davanje na korišćenje, u trajanju do 15 godina.

Ovakva neusaglašenost nije u skladu sa članom 13, stav 2, Zakona br. 06/L-092, kao ni sa članom 6, stav 2, Uredbe (VRK) br. 09/2020, kojima je propisano da spisak nepokretne imovine namenjene za davanje na korišćenje mora sadržati, između ostalog, i vremenski period za koji se nepokretnost planira dati na korišćenje. Samim tim, postupak davanja na korišćenje mora biti usklađen sa prethodno utvrđenim i usvojenim podacima iz godišnjeg spiska opštinske nepokretne imovine.

Činjenično, MALS ocenjuje da predmetna odluka nije usklađena sa važećim zakonodavstvom, kako u pogledu postojećeg imovinskopravnog statusa predmetne parcele, tako i u pogledu vremenskog perioda za koji je ista planirana za davanje na korišćenje.

Shodno navedenom, Skupština opštine Gračanica dužna je da preduzme odgovarajuće mere i da, u zakonskom roku od 30 dana, ponovo razmotri i uskladi predmetni akt sa važećim zakonodavstvom.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za sva dodatna pojašnjenja u vezi sa ovom ocenom.

4435/26 03. 11. 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Општина Грачаница
Komuna e Graçanicës
Municipality of Gračanica

ULAZNA - INCOMING
Ministrimit të Fushtatit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 04. 11. 2026
Datum:
Date:

Njesia organizative	Nr. i Lenites	Vlera
-UL	020-712	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 6 paragrafi 1 pika 1, nenit 14 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 2, nenit 6 paragrafi 3 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) nr.09/20 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e pestë të rregullt, e mbajtur më datën 30.10.2026, merr këtë:

VENDIM PRELIMINAR NR.55/2026/KG

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR - PARCELËS KADASTRALE P-1006-1 ZONA KADASTRALE GUSHTERICË E POSHTME, ME NJË SIPËRFAQE PREJ 23608 M²

Neni 1

MIRATOHET Vendimi preliminar për fillimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë pronën e mëposhtme të paluajtshme të komunës:

1. Parcela kadastrale P-1006-1 Zona kadastrale Gushtericë e Poshtme, me një sipërfaqe prej 23608 m², në vendin e quajtur "Bara", si dhe dokumentacionin shoqërues që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Neni 2

Prona e komunës e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi gjendet në listën e pronave të paluajtshme të komunës të destinuara për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026 (Vendimi nr. 62/2025/KG i datës 30.12.2025).

Neni 3

Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim afatshkurtër për një periudhë kohore prej 15 vjet, me qëllim të kryerjes së aktivitetit afarist, investimeve kapitale me interes për Komunën, qytetarët dhe interesin e përgjithshëm publik, mundësinë e hapjes së vendeve të punës, rritjen e të hyrave vetanake të Komunës, si dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Neni 4

Procedura e dhënies së pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër do të kryhet përmes procedurës së ankandit publik, i cili do të zbatohet nga Komisioni për vlerësim, në përputhje me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 5

Çmimi fillestar i qirasë së pronës së paluajtshme nga neni 1 i këtij Vendimi do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e Rregullores nr.01/2021/KG në fuqi për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, me ndryshimet dhe plotësimet.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore do të kujdeset Komisioni për vlerësim, i cili formohet me një vendim të veçantë nga Kuvendi i komunës.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të aktevetë komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

4435/26 03. 11. 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Општина Грачаница
Komuna e Graçanicës
Municipality of Gračanica

Data 04. 11. 2026
Datum
Date

Njësia organizative	Nr. I Lendes	Viera
-Al-	020-712	

На основу члана 12. став 2. тачка д, члана 14.став 1. и 2. Закона о локалној самоуправи бр. 03/Л-040 („Службени лист РК“ Бр.28/2008), члана 6, став 1, тачка 1, члана 14 Закона о давању на коришћење и о размени општинске непокретне имовине бр. 06/Л-092 („Службени лист РК“ Бр.10/2019), члана 5, став 1, тачка 2, члана 6, став 3 и члана 8. Уредбе ВРК бр.09/2020 о утврђивању процедура о давању на коришћење и о размени општинске непокретне имовине, Скупштина општине Грачаница на петој редовној седници одржане дана 30.10.2026. године доноси:

ПРЕЛИМИНАРНУ ОДЛУКУ БР.55/2026/ОГ

О ПОКРЕТАЊУ ПРОЦЕДУРЕ ЗА ДАВАЊЕ ОПШТИНСКЕ НЕПОКРЕТНЕ ИМОВИНЕ НА КРАТКОРОЧНО КОРИШЋЕЊЕ – КАТАСТАРСКА ПАЦЕЛА П-1006-1, КАТАСТАРСКА ЗОНА ДОЊА ГУШТЕРИЦА, ПОВРШИНЕ 23608 М²

Члан 1.

УСВАЈА СЕ прелиминарна одлука којом се покреће процедура за давање на краткорочно коришћење физичким и правним лицима следећа општинска непокретна имовина:

1. Катастарска парцела П-1006-1, катастарска зона Доња Гуштерица, површине 23608 м², на месту званом Бара, као и пратећој документацији приложеној уз ову одлуку.

Члан 2.

Општинска имовина описана у члану 1 ове одлуке налази се на списку општинске непокретне имовине намењене за давање на коришћење за 2026.годину (Одлука бр. 62/2025/ОГ од 30.12.2025.).

Члан 3.

Општинска непокретна имовина даје се на краткорочно коришћење, на временски период од 15 година, са циљем обављања пословне делатности, капиталних инвестиција од интереса за Општину, грађане и општи јавни интерес, могућност отварања радних места, повећање сопствених прихода Општина, као и локални економски развој.

Члан 4.

Поступак давања општинске имовине на краткорочно коришћење вршиће се поступком јавне аукције који ће спроводити комисија за процену, у складу са одредбама Закона о давању на коришћење и о размени општинске непокретне имовине бр. 06/Л-092 и Уредбе ВРК бр.09/2020 о утврђивању процедура о давању на коришћење и о размени општинске непокретне имовине.

Члан 5.

Почетна цена закупа непокретности из члана 1 ове одлуке одредиће се у складу са одредбама важећег Правилника бр. 01/2021/ОГ о таксама, тарифама и општинским казнама, са изменама и допунама.

Члан 6.

О спровођењу ове одлуке и одговарајућих законских процедура, стара се Комисија за процену која се формира посебном одлуком Скупштине Општине.

Члан 7.

Одлука ступа на снагу 30 дана након подношења надзорном органу, у смислу члана 8. у вези са чланом 9. Закона бр. 08/Л-284 о административном преиспитивању општинских аката, и након објављивања на службеној web страници општине.

Председавајући Скупштине

Милан Димитријевић

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-73409026-01006-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	6712//25
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	24.12.2025 - 13:17
Komuna / Opština / Municipality:	GRAÇANICË / GRAČANICA / GRAÇANICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Gushtericë E Ulët / Donja Gušterica / Gushtericë E Poshtme
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	GRAÇANICË / GRAČANICA / GRAÇANICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-73409026-01006-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land	Rural	23608	0006-87		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BARA				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m^2) Površina (m^2) Area (m^2)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	23608

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Graçanicës - OPŠTINA GRAČANICA	600689519	GRACANICA / GRACANICA / GRACANICA /			1/1		17.07.2013

I. QIRAMARRJE - ZAKUPNINA - LEASEHOLD

Përshkrimi i të drejtës së Qiramarrjes / Opis prava Zakupnina / Right of Leasehold	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Afati dhe kushtet Rokovi i uslovi Terms and conditions	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrim Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Qiramarrje 99 vjet / Zakupninom 99 godine / Under lease for 99 years	SHPK DINO	70080965	GIMNASELLË / GIMNASELLË / GIMNASELLË /		Kontraqnta per dhenjen me qira per 10 vite nga dt.03.03.2010 deri 03.03.2020	/		17.07.2013

5867/IV 30-12-2025

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.06/L-092 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.10/2019), nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të jashtëzakoshme, e mbajtur më datën 30.12.2025, merr këtë:

VENDIM NR.62/2025/KG

për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të destinuara për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026

Neni 1

Miratohet Vendimi për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të destinuara për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

Neni 2

Lista e pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim përbëhet nga pronat e mëposhtme:

Nr.r.	Të dhënat kadastrale	Përshkrimi	Destinimi	Data e publikimit	Afati kohor
1	Parcela nr.1355-1 ZK Llapllasellë	Pjesa e parcelës nr.1355-1 ZK Llapllasellë, sipas PZhK-së të vlefshëm për periudhën 2014-2029 është paraparë për ndërtimin e objekteve publike	Ndërtimi i Stacionit të zjarrfikësve	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim afatgjatë
2	Parcela nr.17-10 ZK Graçanicë	Pjesë e parcelës kadastrale nr.17-10 ZK Graçanicë	Ndërtimi i impiantit për prodhimin e energjisë elektrike nga	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim afatgjatë

			energjia diellore		
3	Parcelat nr.1006-1 dhe 1006-3 ZK Gushterica e Poshtme	Parcelat ndodhen në zonën e biznesit, e cila është përcaktuar me PZhK-në ekzistues për periudhën 2014-2029	Ndërtimi i objekteve afariste	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim afatgjatë
4	Parcelat nr.511-0 dhe 513-0 ZK Llapllasellë	Parcelat përballë shkollës fillore janë të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit afarist	Ushtrimi i aktivitetetit afarist	Gjatë vitit 2026	Shfrytërim afatshkurtër
5	Parcela nr.305-0 ZK Suhadoll	3 lokale në Suhadolll	Ushtrimi i aktivitetetit afarist	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim afatshkurtër
6	Parcela nr.603-0 ZK Lepinë	2 lokale në Lepinë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim afatshkurtër
7	Parcela nr.509-0 ZK Llapllasellë	4 lokale në Llapllaselllë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim afatshkurtër
8	Parcela nr.1434-2 ZK Graçanicë	Lokalet në QT Graçanicë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim deri në 1 vit
9	Parcela nr.516-0 ZK Gushterica e Poshtme	Lokalet në QT Gushterica e Poshtme	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2026	Shfrytëzim deri në 1 vit

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjëse drejtoritë komunale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të aktevetë komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

5867/4 30-12-2025

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

На основу члана 12, став 2, тачка Д и члана 14, став 1, Закона о локалној самоуправи бр. 03/Л-040 („Службени лист РК“ Бр.28/2008), члана 13 Закона о давању на коришћење и о размени општинске непокретне имовине бр. 06/Л-092 („Службени лист РК“ Бр.10/2019), члана 6, став 1 Уредбе ВРК бр.09/2020 о утврђивању процедура о давању на коришћење и о размени општинске непокретне имовине, Скупштина Општине Грачаница на другој ванредној седници одржане дана 30.12.2025. године доноси:

ОДЛУКУ БР.62/2025/ОГ

О УСВАЈАЊУ СПИСКА ОПШТИНСКЕ НЕПОКРЕТНЕ ИМОВИНЕ НАМЕЊЕНЕ ЗА ДАВАЊЕ НА КОРИШЋЕЊЕ ЗА 2026. ГОДИНУ

Члан 1.

Усваја се одлука о усвајању списка општинске непокретне имовине намењене за давање на коришћење за 2026. годину.

Члан 2.

Списак општинске непокретне имовине за давање на коришћење састоји се из следеће имовине:

Р.бр.	Катастарски подаци	Опис	Намена	Датум објављивања	Временски рок
1	Парцела 1355-1 КЗ Лапље Село	Део парцеле бр.1355-1 КЗ Лапље Село, према важећем РПО за период 2014-2029. предвиђена је за изградња јавних објеката	Изградња ватрогасне станице	У току 2026.	Дугорочно коришћење
2	Парцела 17-10 КЗ Грачаница	Део катастарске парцеле бр.17-10 КЗ Грачаница	Изградња постројења за производњу електричне	У току 2026.	Дугорочно коришћење

			енергије из сунчеве енергије		
3	Парцела 1006-1 и 1006-3 КЗ Доња Гуштерица	Парцеле се налазе у бизнис зони, која је дефинсинана постојећим РПО за период 2014-2029	Изградња пословних објеката	У току 2026.	Дугорочно коришћење
4	Парцеле 511-0 и 513-0 КЗ Лапље Село	Парцеле преко пута основне школе, погодне за обављање пословне делатности	Обављање пословне делатности	У току 2026.	Краткорочно коришћење
5	Парцела 305-0 КЗ Суви До	3 локала у Сувом Долу	Обављање пословне делатности	У току 2026.	Краткорочно коришћење
6	Парцела 603-0 КЗ Лепина	2 локала у Лепини	Обављање пословне делатности	У току 2026.	Краткорочно коришћење
7	Парцела 509-0 КЗ Лапље Село	4 локала у Лапљем Селу	Обављање пословне делатности	У току 2026.	Краткорочно коришћење
8	Парцела 1434-2 КЗ Грачаница	Локали у ТЦ Грачаница	Обављање пословне делатности	У току 2026.	Коришћење до 1 године
9	Парцела 516-0 КЗ Доња Гуштерица	Локали у ТЦ Доња Гуштерица	Обављање пословне делатности	У току 2026.	Коришћење до 1 године

Члан 3.

За спровођење ове одлуке надлежна су општинска одељења.

Члан 4.

Ова одлука ступа на снагу 30 дана након подношења надзорном органу, у смислу члана 8. у вези са чланом 9. Закона бр. 08/Л-284 о административном преиспитивању општинских аката, и након објављивања на службеној web страници општине.

Председавајући Скупштине

Милан Димитријевић